



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional**  
**“Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”**  
**i**  
**Institucionit të Arsimit të Lartë**  
**“Fan S. Noli, Korçë”**  
**UNIKO**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Dilina Beshiri

2. Dr. Leticja Gusho

Shkurt/2021

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Për Programin e studimit: Program me karakter profesional në “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan. S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr.537, datë 26.10.2017
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 63, datë 09.04.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15/2
18	Numri i studentëve:	64
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Në kuadrin e akreditimit të Programi të Studimit me Karakter Profesional “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme” kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, “Fan. S. Noli” Korçë, (UNIKO), është realizuar procesi respektiv i vlerësimit, duke u bazuar kryesisht në aktivitetet e realizuara sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me karakter profesional, me emërtesë “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme” (EFFH) i ofruar nga Departamenti i Edukimit. Ky departament është pjesë e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë. Ky program studimi është hapur me Urdhër MASR nr.537, datë 26.10.2017, (mbështetur në VKA nr.72, datë 21.09.2017), me kohëzgjatje 2 vite (4 semestra). Ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në listën kombëtare të profesioneve të rregulluara, miratuar me VKM nr.514, dt 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”.


Ky program studimit me karakter profesional përmban gjithsej 120 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ndër vite ka qenë:

Për vitin akademik 2019-2020 është 25 studentë.

Për vitin akademik 2018-2019 ka qenë 34 studentë.

Për vitin akademik 2017-2018 ka qenë 5 studentë.

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### *Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm*

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr.531, datë 11.09.2018, për programin e studimit me karakter profesional. ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UNIKO-FEF, për të realizuar takimet në institucion, si edhe për të përpiluar raportin përfundimtar të vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Dilina Beshiri dhe Dr. Leticja Gusho. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Msc.Aviola Bardhi.

*Dokumentacioni ligjor mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm*

Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur vlerësimi i jashtëm është:

- Ligji nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhër MASR nr.537, datë 26.10.2017, (mbështetur në VKA nr.72, datë 21.09.2017)
- VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
- VKM nr.531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

### **Aktivitet kryesor të realizuara**

Në kuadër të këtij vlerësimi janë kryer disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

**Analiza e të dhënave parësore.** Të dhënat parësore janë nxjerrë nga: Raporti i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit me karakter profesional në “Edukimi për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme” (2020) i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm; Statuti i UNIKO; Rregullore e UNIKO; Rregullore e Fakultetit të Edukimit; Paketa e plotë e dokumentacionit të programit; Programet lëndore; si dhe dokumentacione të tjera administrative si dokumentacioni i personelit.

**Analiza e të dhënave dytësore.** Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara përmes Platformës Zoom. Si rezultat i shtrirjes së efektit të Pandemisë prej COVID-19, në kuadër të zbatimit të protokollit të përcaktuar nga Komisioni Teknik i Ekspertëve në Republikën e Shqipërisë, si edhe nga aktet normative në fuqi, vizitat e planifikuara në ambjentet e institucionit UNIKO, Fakultetit të Edukimit dhe Filologjik (FEF), Departamentit të Edukimit (DE), nuk u zhvilluan në kushtet e pranisë fizike në Institucion, por përmes realizimit të takimeve online si edhe përmes përdorimit të platformave të konsoliduara me format video dhe audio dhe që kanë përdorim të gjerë për qëllime të këtij lloji. Takimet sipas agjendës së paracaktuar dhe të dakordësuar nga të dy institucionet janë zhvilluar në datat 16 dhe 17 Dhjetor 2020. Gjatë këtyre takimeve, u zhvilluan bashkëbiseda të qëllimta si edhe vëzhgime të natyrave të ndryshme. Kështu, u

realizuan biseda të drejtuara si ajo me Rektoren e UNIKO; bisedë me drejtuesin e Njesisë kryesore, Dekanen e Fakultetit të Edukimit; bisedë me Përgjegjës të Departamentit të Edukimit përgjegjës për programin e “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”; bisedë me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm; bisedë me stafin akademik të programeve të studimit; bisedë me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit; bisedë me përfaqësues të Qendrës së Karrierës dhe Alumnit; bisedë me përfaqësues të studentëve të programit të studimit “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”; bisedë me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor; si edhe bisedë me Koordinatorin e projekteve Erasmus+.

### **Vëzhgimi i mjediseve**

Si edhe u cilësua më sipër, si rezultat i pandemisë prej COVID-19, vizitat në institucion nuk janë realizuar në prezencë fizike. Stafi i UNIKO-s, ka patur gjatë gjithë kohës një përkushtim maksimal për t’i siguruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të gjithë elementët e nevojshëm për ta kaluar edhe këtë pengesë. Kështu, anëtarë të stafit përmes përdorimit të mjeteve teknologjike audio-vizuale, mundësuan vëzhgime mjaft cilësore të auditorëve, të laboratorëve të informatikës, të sekretarisë, si edhe të ambjenteve të bibliotekës.

Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

Më datë 21.01.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/4 prot, datë 21.01.2021, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 27.01.2021 dhe me shkresë zyrtare Nr.167/1 Prot, datë 27.01.2021.

### **GVJ pasi u njohën me komentet e institucionit mbi Draft- Raportin sqaron si vijon:**

**Konstatim i GVJ:** Standardi IV.3, Kriteri 2: Nga takimi virtual me Drejtorinë e Bibliotekës rezultoi se biblioteka ka në dispozicion një fond librash me 2600 tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj. 200 tituj prej tyre janë libra dedikuar programit profesional EFSH për realizimin e veprimtarive mësimore sipas moduleve të ofruara. *Institucioni nuk ka paraqitur një dokument statistikor për fondin e librave në total dhe në funksion të këtij program studimi.*

**Komenti i IAL:** rekomandimi në standardin IV.3, kriteri 2, gjeni bashkëngjitur shtojcën 1 “Fondi i librave në funksion të programeve të studimit”

### **Përgjigjja GVJ:**

GVJ pasi shqyrtoi dokumentin “Fondi i librave në funksion të programeve të studimit” paraqitur nga institucioni reflekton ndryshimin e standardit IV.3/2: Nga takimi virtual me Drejtorinë e Bibliotekës rezultoi se biblioteka ka në dispozicion një fond librash me 2600 tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj. 9 tituj prej tyre janë libra dedikuar programim profesional EFSH për realizimin e veprimtarive mësimore sipas moduleve të ofruara.

*Fondi i librave i deklaruar nga institucioni në funksion të këtij program studimi është shumë i vogël, vetëm 9 tituj.*

Vlerësimi për Standardin IV.3 nuk ndryshon, GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.

**Konstatim i GVJ:** Standardi V.4, Kriteri 5 Nëpërmjet instrumenteve matës për vlerësimin e stafit dhe pyetësor për studentët, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.

**Komenti i IAL:** Standardi V.4, Kriteri 5 gjeni bashkëngjitur shtojcën 3 "Pyetësor fund kursi" me analizën e të dhënave përkatëse.

**Përgjigjja GVJ:**

GVJ pasi shqyrtoi shtojcën 3 "Pyetësor fund kursi" me analizën e të dhënave përkatëse paraqitur nga institucioni, vlerëson përpjekjet e institucionit për realizimin e Pyetësor fund kursi, *por i qëndron vlerësimit fillestar* për Standardin V.4, Kriteri 5: Nëpërmjet instrumenteve matës për vlerësimin e stafit dhe pyetësor për studentët, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës ndërsa,  
Vlerësimi për Standardin V.4, Kriteri 5 nuk ndryshon, GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.

**Konstatim i GVJ:** Standardi I.I, Kriteri 6: Nga bisedat me stafin e zyrës së Alumnit si edhe nga dokumentacioni i depozituar, rezulton se institucioni disponon të dhëna përse i përket punësimit të studentëve dhe gjithashtu Institucioni ka pasqyruar një dokumentacion të plotë mbi marrëveshjet e bashkëpunimit dhe komunikimin me punëdhënësit e fushës, si edhe me kërkesat dhe nevojat e tyre. *Nga shqyrtimi i RVB dhe bisedat me stafin akademik rezulton se DE nuk ka kryer një studim paraprak të tregut të punës për programin e studimit me karakter profesional "Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme".*

**Komenti i IAL:** konstatimit të ekspertëve të jashtëm në Standardin 1.1, kriteri 6, sqarojmë se Departamenti i Edukimit ka kryer studim tregu bazuar në të dhëna rajonale sipas kërkesave që ka pasur projekti "Arsim Gjithëpërfshirës me fokus fëmijët me Aftësi të Kufizuar në kopshtet/shkollat e zakonshme" i cili parashikonte hapjen e dy programeve të studimit në fushën e foshnjërisë dhe fëmijërisë së hershme në dy universitetet e përfshira në projekt (Konçë dhe Elbasan). Dokumentacioni mbështetës për argumentimin e hapjes së programit është bashkëngjitur në shtojcën 3.8 sipas formatit të kërkuar nga MASR për aplikimin e programit dhe kërkesave të projektit që mbështeti hapjen e programit.

**Përgjigjja GVJ:**

GVJ pasi rishqyrtoi të gjithë dokumentacion RVB dhe shtojcën 3.8 të paraqitur nga institucioni, sqaron se *i qëndron vlerësimit fillestar*, ashtu sikurse specifikohet në RVB e institucionit për mungesën e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës si dhe vetëvlerësimin që institucioni i ka bërë këtij kriteri.  
Vlerësimi për Standardin I.I, kriteri 6 nuk ndryshon, GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.

**Konstatim i GVJ:** Standardi II.2, Kriteri 5: Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe RVB, GVJ konstatoi se ka një shpërndarje deri diku të ekuilibruar midis veprimtarive formuese, në një

raport që përputhet pothuajse me atë të shtojcës 1 të VKM nr.41 datë 24.01.2018. Studenti merr 23 ECTS në kategorinë e lëndëve që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme, 39 ECTS në kategorinë e lëndëve karakterizuese që lidhen edhe me veçoritë e programit të studimit dhe që u japin studentëve aftësitë e nevojshme profesionale, ndërsa lëndët ndërdisiplinore/integruese dhe lëndët plotësuese përmbajnë 26 ECTS. Kategoria përmbyllëse mund të jetë provim përfundimtar ose punim diplome dhe që është e vlerësuar me 4 ECTS. Një kredit është i përbërë nga 25 orë mësimore. *Rekomandohet që të rishihet shpërndarja në kategorinë e lëndëve karakterizuese dhe që u japin studentëve aftësitë e nevojshme profesionale, në mënyrë që të arrihet dhe detyrimi ligjor për këtë kategori lëndësh me mbulim deri në 30 - 40% të të gjithë ngarkesës së programit të studimi.*

**Komenti i IAL:** Lidhur me rekomandimin në standardin II.2, kriteri 5, sqarojmë se rregulloret e programit të studimit EFFH, të paraqitura në shtojcën 2.5. janë hartuar në bazë të VKM 41 datë 24.1.2018 "Për Elementët e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" në të cilën nuk parashikohet ndarja e lëndëve me kategori për programet profesionale. Rekomandimi i eksperteve të jashtëm është marrë parasysh në përditësimin e rregullores për vitin akademik 2020-2021 dhe në vazhdim pas daljes së VKM 879 date 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41. Datë 24.1.2018"

**Përgjigjja GVJ:**

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit por *rekomandon që të rishihet shpërndarja në kategorinë e lëndëve karakterizuese që u japin studentëve aftësitë e nevojshme profesionale, në mënyrë që të arrihet dhe detyrimi ligjor për këtë kategori lëndësh me mbulim deri në 30 - 40% të të gjithë ngarkesës së programit të studimi, sipas VKM 879 datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41. Datë 24.1.2018"*

Vlerësimi për Standardin II.2, kriteri 5 nuk ndryshon, GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.

**Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit dhe synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kombëtare duke përgatitur edukatorë që do të punojnë për këtë drejtim. Programi i studimit është në përputhje të plotë me filozofinë dhe strategjinë e përzgjedhur nga UNIKO, pasqyruar edhe në Statut <sup>1</sup> , për të ndërtuar në rajonin juglindor një qendër arsimore publike urbane.
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti dhe Rregullorja e Institucionit kanë të përcaktuara drejtimit prioritar. Kështu, në nenin 2 të Statutit të këtij institucioni, në mënyrë eksplicite, është shprehur që institucioni ka për mision që të krijojë, të transmetojë dhe të zhvillojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe me anë të shërbimeve, duke përgatitur profesionalisht specialistë të lartë në të gjitha fushat e studimit që ai ofron <sup>2</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Fushat e studimit për këto programe, përkohë me fushat dhe drejtimit e kërkimit në UNIKO. Programet e studimit të cilat ofrohen nga FEF përputhen me fushat strategjike të strategjisë së zhvillimit të Institucionit. Kështu, në Planin Strategjik të Zhvillimit të Institucionit, në faqen 21, është përcaktuar fusha e edukimit si një nga fushat strategjike prioritar, ku janë dhënë objektivat strategjike dhe treguesit për këtë fushë <sup>3</sup> . Programi i studimit ka objektiva të shprehura qartë dhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me fushën e foshnjërisë dhe të fëmijërisë së hershme, ku studentët kanë mundësi të fitojnë kompetenca profesionale, të cilat gjenerojnë rezultate të pritshme.

<sup>1</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.1, Statuti i Univeritetit Fan S. Noli", ASCAL, Dok. nr. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>2</sup> Ibid

<sup>3</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.3, Plani Strategjik i zhvillimit të UNIKO", ASCAL, Dok. nr. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni<sup>4</sup>, dokumenti për studimin e tregut të punës pasqyron vetëm një pjesë të instrumentave të cilat janë përdorur për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për justifikimin e hapjes së këtij programi studimi. Gjithashtu, duhet të ishte më i plotë argumentimi interpretues për hapjen e këtij programi studimi, si një domosdoshmëri integruese e sistemit edukativ të shërbimeve për moshën 0-3 vjeç, duke u mbështetur jo vetëm në përvojat e fituara dhe bazën ligjore në fuqi, por gjithashtu dhe në partneritetet me Universitetin e Bolonjës, si edhe me organizata të tjera.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Duke qënë se programi i studimit “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”, është një program i ri studimi, me një kohëzgjatje vetëm 2 vjeçare që nga fillimi i aplikimit të tij, zhvillimi i studimeve periodike dhe ndryshimeve përkatëse lidhur me punësimin e studentëve, mund të zhvillohet nga institucioni në të ardhmen e afërt.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga bisedat me stafin e zyrës së Alumnit si edhe nga dokumentacioni i depozituar, rezulton se institucioni disponon të dhëna<sup>5</sup> përse i përket punësimit të studentëve dhe gjithashtu Institucioni ka pasqyruar një dokumentacion të plotë mbi marrëveshjet e bashkëpunimit<sup>6</sup> dhe komunikimin me punëdhënësit e fushës, si edhe me kërkesat dhe nevojat e tyre<sup>7</sup>.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i RVB dhe bisedat me stafin akademik rezulton se DE nuk ka kryer një studim paraprak të tregut të punës për programin e studimit me karakter profesional “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të**

<sup>4</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.8, Studim Tregu pune periodik në kuadër të hapjes së programit të studimit ", ASCAL, Dok. Nr. 50. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>  
<sup>5</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.25, Gjurmim Alumni", ASCAL, Dok. Nr.67. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>  
<sup>6</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.10, Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të programit të studimit", ASCAL, Dok. Nr.40. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>  
<sup>7</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.24, Veprimtari në kuadër të marrëveshjeve bashkëpunimi me Bashkinë Korçë", ASCAL, Dok. Nr.66. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

**realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Institucioni UNIKO, me anë të akteve të miratuara dhe bazës dokumentare të brendshme, ka mundur marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Në këtë kontekst, Rregullorja e Programit të Studimit<sup>8</sup>, e mbështetur edhe në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë nr.80/2015, përmban të gjithë elementët e nevojshëm për administrimin e programit. Në funksion të programit të studimit, UNIKO ka bërë të mundur ndarjen e detyrave mes njësive e personelit, duke mos krijuar mbivendosje kompetencash apo mungesa të dokumentacionit që lidhen me mbarëvajtjen e programit. Plotësimi i personelit akademik me figura profesionale të fushës, ka bërë të mundur që të gjitha veprimtaritë të kryhen në kuadër të realizimit të proceseve akademike të këtij programi studimi<sup>9</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga dokumentacioni i depozituar, konstatohet se për arritjen e objektivave të këtij programi studimi, Departamenti i Edukimit bashkëpunon me njësitë e tjera bazë të UNIKO-s për mësimdhënien e lëndëve/moduleve që u përkasin formimit të përgjithshëm dhe formimit teknologjik të studentëve.<sup>10</sup> Kjo njësi bazë ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi me Departamentin e Shkencave të Edukimit "Giovanni Maria Bertin" të Universitetit të Bolonjës, për rritjen e cilësisë së kurrikulës së programit të studimit<sup>11</sup>. Marrëveshjet e tjera që mund të përmenden janë edhe marrëveshjet me Bashkinë e Korçës, e cila përcakton dhe mënyrat e aksesit të studentëve në institucionet e çerdheve për zhvillimin e praktikave.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e</p>	<p>Nga bisedat e bëra me drejtuesen e njësisë bazë, me stafin përgjegjës për këtë program studimi, si edhe nisur nga dokumentacioni i depozituar<sup>12</sup>, u konstatua që njësia bazë në mënyrë periodike harton raporte të veçanta për mbarëvajtjen</p>

<sup>8</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional "Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme"", ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>9</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit", ASCAL, Dok. nr.81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>10</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme"", ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>11</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.10, Marrëveshje bashkëpunimi në Mbështetje të Programit të Studimit", ASCAL, Dok. nr.40. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>12</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.5, Raportimi i përfitimeve nga marrëveshjet për programet e studimit", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	e marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke patur si indikator kryesor ndikimin pozitiv që ato kanë në ecurinë e programit të studimit "Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme".			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Zhvillimi i praktikës profesionale ka qënë një nga pikat në vëmendje të Njesisë Bazë. Për këtë, Departamentit i Edukimit ka nënshkruar marrëveshje institucionale me institucionet përkatëse për mbikëqyrjen e praktikave profesionale të studentëve. <sup>13</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Departamenti i Edukimit është ofruar me ekspertizën e tij si koordinator pedagogjik <sup>14</sup> në shërbim të çerdheve dhe ka nxitur në mënyrë të vazhduar Bashkinë e Korçës për punësimin e studentëve të cilët mbarojnë këtë program studimi. Nga bisedat e bëra me stafin e UNIKO-s, deri tani rezulton vetëm një student i punësuar nga ky program studimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Mbështetur në legjislacionin kryesor në fuqi dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, më konkretisht në VKM nr.41, datë 24.1.2018, (e ndryshuar), ky program studimi është strukturuar me lëndë/module që mbulojnë 30 ECTS në semestër. Është një program me 120 ECTS, i shtrirë në dy vite akademike dhe i organizuar në katër semestra (me nga 15 javë mësimore secila). <sup>15</sup>

<sup>13</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.10, Marrëveshje bashkëpunimi në Mbështetje të Programit të Studimit", ASCAL, Dok. nr.40. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>14</sup> Ibid

<sup>15</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.26, Struktura e Vitit Akademik", ASCAL, Dok. nr.68. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni<sup>16</sup>, konstatohet se programi i studimit “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”, është i strukturuar në lëndë/module të cilat synojnë të japin njohuri teorike dhe praktike studentëve për arritjen e standardeve të larta në shërbimet që ata do të ofrojnë për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, duke zbatuar teoritë dhe praktikën e të nxënësve dhe të përkujdesjes në lidhje me karakteristikën e grupmoshës, me objektivat e arsimit gjithëpërfshirës, si edhe me rolin e edukatorit si profesionist në një kontekst social në ndryshim.<sup>17</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Ky program studimi mundëson hapin e parë drejt profesionit të edukatorit të grupmoshave nga 0-3 vjeç, ndërsa studentët që përfundojnë këtë program kanë mundësi të punojnë si në çerdhet shtetërore, ashtu dhe ato jopublike. Studentët pajisen me një sërë aftësish njohëse dhe proaktive për zgjidhjen e situatave problemore, për menaxhimin e mjedisit njohës, social, emocional dhe fizik të grupit nëpërmjet zhvillimit, midis të tjerave, edhe të laboratorëve dhe praktikave profesionale.<sup>18</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Programi i studimit EFFH parashikon formimin e studentëve me kompetencat teorike të natyrës pedagogjike dhe psikosociale për të realizuar në mënyrë sa më të plotë të kuptuarit e kushteve të foshnjërisë dhe të fëmijërisë së hershme, si edhe formimin e tyre me kompetenca praktike dhe funksionale për zhvillimin e proceseve edukuese, shtuar formimin e kompetencave didaktike dhe kompetencave të tjera të duhura për ndërtimin e marrëdhënieve me realitete të ndryshme familjare. Të gjitha syllabuset e paraqitura nga Institucioni kanë të hartuara rezultatet e të nxënësve dhe kompetencat e pritshme që zhvillon ky program studimi.<sup>19</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës</p>	<p>Për arritjen e këtij kriteri, Departamenti i Edukimit në bashkëpunim edhe me njësi bazë të tjera të UNIKO-s, kanë rekrutuar si Personel Akademik Efektiv (PAE), ashtu dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), të kualifikuar në specialitetet përkatëse. Kështu, në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni konstatohet që ka një raport të mirëekuilibruar lidhur me rekrutimin e personelit të cilët mbajnë grada shkencore dhe tituj akademikë.<sup>20</sup></p>

<sup>16</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Programet lëndore (Syllabuset)", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>17</sup> Ibid

<sup>18</sup> Ibid

<sup>19</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Programet lëndore (Syllabuset)", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>20</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.8, Jetëshkrimet e Stafit të përfshirë në programin e studimit", ASCAL, Dok. nr.38. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Evidencat e dorëzuara<sup>21</sup> dëshmojnë për cilësi të kënaqshme të stafit akademik të brendshëm e të jashtëm të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit. Sipas kësaj evidence, konstatohet se përsa i përket stafit akademik të angazhuar për programin e studimit Me karakter profesional në “Edukimi për Foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme”, <b>për vitin akademik 2018-2019</b>, rezultojnë të jenë të angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi gjithsej 16 PAE, nga të cilët 1 personel me titullin Prof.Dr, 3 personel me titull Prof.Asoc.Dr, 4 personel me gradën Dr/PhD, 1 personel në proces doktorature, 1 personel PAE me gradën Docent, 6 personel asistent-lektor me Msc. Përsa i përket personelit akademik me kontratë, për këtë program studimi rezultojnë të jenë të angazhuar 3 personel PAK. Ky personel rezultojnë të jetë asistent-lektor me gradën MSc.</p> <p>Raporti për vitin akademik 2018 -2019, që del nga të dhënat e dokumentacionit për PAE/PAK thekson <b>mbulimin në masën 84.2% me personel akademik efektiv, dhe 15.8% me personel akademik me kontratë.</b></p> <p>Për <b>vitin akademik 2019-2020</b>, stafi në mbështetje të programit të studimit Me karakter profesional në “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme” përbëhej nga 15 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 1 personel me titull “Profesor”, 4 personel me titull “Profesor i Asociuar”, 4 personel me gradën “Doktor i Shkencave”/PHD, 5 personel PAE me kualifikimin “Master i Shkencave” (nga të cilët 1 në ndjekje të studimeve doktorale). Përsa i përket stafit akademik me kontratë (PAK), për vitin akademik 2019-2020, rezultojnë vetëm 2 personel PAK me kualifikimin “Master i Shkencave”<sup>22</sup>.</p> <p><b>Raporti PAE/PAK për vitin akademik 2019-2020 rezultojnë 88.2% me 11.8%.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë objektivat e programit të studimit “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”<sup>23</sup>, duke nënvizuar që ky program synon përgatitjen e studentëve me formim të gjerë mbi spektrin e zhvillimit të fushave të ndryshme dhe edukimit në foshnjërinë dhe në fëmijërinë e hershme, mbi zhvillimin e</p>


<sup>21</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit", ASCAL, Dok. nr.81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>22</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit (Tabela Nr.7)", ASCAL, Dok. nr.81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>23</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional” Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”", ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	aftësive komunikuese dhe ndërvepruese në situata dhe mjedise të caktuara, si edhe pajisjen e tyre me aftësi praktike për të mundësuar formimin e profesionistëve të fushës me kompetenca të plota për tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Gjatë gjithë strukturës të programit të studimit, objektivat formues, rezultatet e të nxënit, struktura, si edhe përmbajtja e programit të studimit garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive, shkathtësive dhe kompetencave të cilat synojnë të formojnë edukatorë të institucioneve të çerdheve të pajisur si me kompetencat shkencore, ashtu edhe me ato pedagogjike. Një vend i veçantë në program i jepet hapësirës së të menduarit kritik dhe krijues. <sup>24</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.	Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, Programi i studimit EFFH është i organizuar në lëndë/module, aktivitete formuese, të dhëna këto që detajohen në kurrikulën dhe Rregulloren e Programit të Studimit <sup>25</sup> . Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni, konfirmohet që programi i studimit Me karakter profesional në “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme” është me kohëzgjatje 2 vite akademike (me 120 ECTS), në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Europian të Grumbullimit dhe të Transferimit të Krediteve. Nga Plani Mësimor i Programit MP për EFFH, vërtetohet se të gjitha lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me kredite sipas klasifikimit të tyre në lëndë të kategorisë A, B, C, si edhe D <sup>26</sup> . Konfirmohet që ky program studimi është me kohëzgjatje 2 vite akademike, organizuar në katër semestra për vit akademik dhe me kohëzgjatje normale për 15 javë, ku studenti përfiton në total 120 ECTS <sup>27</sup> .  <i>Rekomandojmë rishikimin e kurrikulës sipas veprimtarive</i>

<sup>24</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>25</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit", ASCAL, Dok. nr.81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>26</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit", ASCAL, Dok. nr.81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>27</sup> Ibid

	<i>formuese të nivelit V të KSHK bazuar në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.	Plani mësimor <sup>28</sup> i programit EFFH jep çdo lloj informacioni në lidhje me ndarjen e lëndës në semestra, ngarkesën mësimore, si edhe orët e punës individuale për çdo lëndë.		
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.	Programi i studimit EFFH ka në përmbajtjen e tij të gjitha syllabuset lëndore, të detajuara për çdo lëndë. Nga bisedat e realizuara me përgjegjësin e njësisë bazë, si edhe nga konsultimi me RVB, konstatohet që syllabuset miratohen në fillim të çdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit dhe janë të hartuara sipas udhëzimeve specifike të përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi (VKM nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL, e ndryshuar). Syllabuset e lëndëve në përfshirje të kurrikulës strukturohen sipas formatit të miratuar, ku në to paraqiten rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat për çdo javë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, si edhe literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar <sup>29</sup> .		
<b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.	Programi i studimit të EFFH ka një ekulibër të mirëpërcaktuar midis moduleve/lëndëve të vlerësuara me kreditet përkatëse sipas kategorive specifike, bazë, karakterizuese, integruese, si edhe plotësuese.		
<b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	Formimi praktik i studentëve dhe i elementëve të punës konkrete realizohen me anë të zhvillimit në të dy vitet e studimit të "Laboratorëve për formimin profesional", lëndë e cila në total është e vlerësuar me 14 ECTS. <sup>30</sup>		
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>

<sup>28</sup> Ibid

<sup>29</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit", ASCAL, Dok. nr.81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>30</sup> Ibid



standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

## Standardi II.2

**Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi është në përputhje të plotë me nenin 75, pika 6, të Ligjit të Arsimit të Lartë nr.80/2015 <sup>31</sup> “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë pikë përcaktohet se programet me karakter profesional organizohen me 60 ose me 120 kredite dhe kohëzgjatja e tyre është një vit ose dy vite akademike. Ky program studimi është me 120 kredite dhe me një kohëzgjatje 2 vite akademike. Gjithashtu, ky program ofrohet në përputhje të plotë me misionin dhe vizionin e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë dhe të Departamentit të Edukimit. <sup>32</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Programi i EFFH ka një shpërndarje të mirë të ngarkesës në katër semestra akademike, duke mundësuar arritjen e objektivave formues të programit të studimit. GVJ konstaton se në vitin e parë të programit zhvillohen 14 lëndë gjithsej me 60 ECTS. 12 lëndë zhvillohen në vitin e dytë dhe këto të përcaktuara me 60 ECTS. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në dy vitet është e balancuar dhe le hapësira për kombinim e duhur teoriko-praktik, ku gjejnë vend edhe zhvillimi i Laboratorëve për formimin profesional.
<b>Kriteri 3.</b> Planu mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabusët e moduleve e të aktivitetëve formuese janë informuese	Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.80/2015 (neni75) <sup>33</sup> . Nga dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni, konstatohet që plani mësimor i programit dhe të gjithë elementët e tij

<sup>31</sup> Ligji nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 75, pika 6.

<sup>32</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.3, Rregullore e Njesisë Bazë “Departamenti i Edukimit”, ASCAL, Dok. nr.31. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>33</sup> Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 70

<p>dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>përbërës shërbejnë si mjete të plota informuese për programin e studimit.<sup>34</sup> Studimet përmbillen me provim përfundimtar formimi, ose punim diplome e cila ka në total 4 ECTS. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me “Diplomë Profesionale në Edukimin për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”.<sup>35</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Nga analiza e realizuar e Planit Mësimor të programit të studimit, del në pah që raporti module të formimit teorik/module të formimit praktik anën në favor të teorisë. Rreth 15% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë dhe punës konkrete me aktivitete të lidhura me ushtrimin e profesionit.</p> <p><i>Në këtë kontekst rekomandohet që të rishikohet dhe një herë Plani Mësimor i EFFH në mënyrë që të ketë një rishpërndarje me të balancuar duke i dhënë më shumë hapësirë aktiviteteve të formimit praktik.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe RVB<sup>36</sup>, GVJ konstatoi se ka një shpërndarje deri diku të ekuilibruar midis veprimtarive formuese, në një raport që përputhet pothuajse me atë të shtojcës 1 të VKM nr.41 datë 24.01.2018<sup>37</sup>. Studenti merr 23 ECTS në kategorinë e lëndëve që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme, 39 ECTS në kategorinë e lëndëve karakterizuese që lidhen edhe me veçoritë e programit të studimit dhe që u japin studentëve aftësitë e nevojshme profesionale, ndërsa lëndët ndërdisiplinore/integruese dhe lëndët plotësuese përmbajnë 26 ECTS. Kategoria përmbyllëse mund të jetë provim përfundimtar ose punim diplome dhe që është e vlerësuar me 4 ECTS. Një kredit është i përbërë nga 25 orë mësimore.</p> <p><i>Rekomandohet që të rishihet shpërndarja në kategorinë e lëndëve karakterizuese dhe që u japin studentëve aftësitë e nevojshme profesionale, në mënyrë që të arrihet një raport i balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth</i></p>

<sup>34</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit", ASCAL, Dok. nr.81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>35</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.7, Modeli i Diplomës/Suplementit të Programit të Studimit", ASCAL, Dok. nr.37. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>36</sup> UNIKO, FEF, DE, "RVB PP EFFH 2020", ASCAL, Dok. nr.28. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>37</sup> VKM Nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL"

	25% e programit duhet t'i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. <sup>38</sup>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
<b>Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe.</b>	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, Programi i Studimit EFFH është i organizuar në lëndë/module, aktivitete formuese, të dhëna që janë të detajuara në kurrikulën, në planin, si edhe në Rregulloren e programit të studimit <sup>39</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni <sup>40</sup> , (RVB) <sup>41</sup> , përmbajtja e programit të studimit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit të Edukatorit për grupmoshën 0 deri në 3 vjeç.
<b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit se përmbajtja e programit parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme. Kështu modulet/lëndët janë të kategorizuara si disiplina të formimit bazë, të formimit karakterizues, ndërdisiplinore, si edhe disiplina të tjera plotësuese. Në kurrikulën e programit të EFFH është shprehur dallimi midis përvojës profesionale dhe kompetencave themelore. Gjithashtu, është e dukshme koherenca midis rezultateve të të nxënit, metodave të mësimdhënies/të mësuarit, si edhe formave të vlerësimit.

<sup>38</sup> VKM Nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL" (Shtojca 1)

<sup>39</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.6, Plani mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dok. nr.36. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>40</sup> Ibid

<sup>41</sup> UNIKO, FEF, DE, "RVB PP EFFH 2020", ASCAL, Dok. nr.28. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p><b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>Nga analiza e syllabuseve të lëndëve<sup>42</sup> u konstatua se njohuritë e marra në këtë program studimi u mundësojnë studentëve përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, si edhe zgjidhjen e problemeve. Në këtë kontekst, në një pjesë të lëndëve studentëve u kërkohet të prezantojnë në mënyrë krijuese dijet e përfituara dhe propozimet e tyre për përmirësimin e mundshëm të situatave specifike me të cilat janë ndeshur me anë të zhvillimit të detyrave/projekteve, formati i të cilave është i unifikuar dhe i miratuar nga Njësia Bazë<sup>43</sup>. Në funksion të këtij programi është Laboratori EFFH, dhe duhet shtuar se Lënda mësimore “Laborator për zhvillimin profesional” zhvillohej përgjatë dy viteve të studimit dhe ka në total 14 ECTS<sup>44</sup>.</p>
---	--

<p><b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Në programin e studimit nuk ka në mënyrë eksplicite lëndë të praktikës. Nga bisedat e realizuara me Koordinatorin e Programit EFFH, ky parametër mbulohet në “Laboratorin për zhvillimin profesional”. Gjithashtu, përmes nënshkrimit institucional të marrëveshjeve me Bashkinë e Korçës, studentëve u mundësoheshin vizita dhe praktika afatshkurtra profesionale në mjedise të ndryshme të çerdheve të qytetit.</p> <p><i>Rekomandojmë që praktika të specifikohet si lëndë më vete në Planin Mësimor të programit EFFH dhe me ngarkesë ECTS të përcaktuar dhe nga aktet nënligjore në fuqi.</i><sup>45</sup></p>
--	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<sup>42</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Programet lëndore (Syllabuset)", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>43</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.27, Model detyre, projekt\_studientor", ASCAL, Dok. nr.67. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>44</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.6, Plani mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dok. nr.36. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>45</sup> VKM Nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” (Shtojca 1)

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	Institucioni ka të organizuar Sektorin e Kurrikulave dhe të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (SKVBC), si një nga mekanizmat e monitorimit të rëndësishëm dhe që bën vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore dhe shkencore dhe që ka pavarësi veprimi dhe akses në të dhënat e Institucionit. <sup>46</sup> Gjithashtu, veprimtaria e kësaj strukture është e përshkruar edhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë së UNIKO. <sup>47</sup> Studentët janë të përfshirë në këtë proces me anë të Pyetësorit studentor <sup>48</sup> , që është një nga instrumentat e mbledhjes së të dhënave për realizimin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura nga stafi, si ai PAE, ashtu edhe ai PAK. Të gjitha të dhënat e raporteve të vlerësimit të brendshëm publikohen në faqen zyrtare të UNIKO. <sup>49</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, si edhe nga bisedat me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se format e mësimdhënies, së të nxënit, si edhe të transmetimit të dijes janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit, laboratorët profesionalë, etj. Gjithashtu, edhe në këtë Institucion, si në të gjithë Republikën e Shqipërisë, mësimi po zhvillohet online, përmes përdorimit të platformës Microsoft Teams.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në	Të gjitha formatet e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit, të pasqyruara në Syllabuset lëndore, janë në përputhje me diversitetin si edhe me nevojat e studentëve. Raporti midis formave të ndryshme të mësimdhënies dhe të

<sup>46</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.5, Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe të kërkimit shkencor", ASCAL, Dok. nr.6. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>47</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.16, Manual i cilësisë së UNIKO", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>48</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.13, Model pyetsori Studentor", ASCAL, Dok. nr.55. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>49</sup> <https://www.unkorce.edu.al/sq/node/665>

përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	të nxënit ndryshon në varësi të natyrës së programit të studimit <sup>50</sup> . Gjithashtu, stafi akademik inkurajohet që në mënyrë të vazhduar të shkëmbejë përvoja të ndryshme të metodave të mësimdhënies dhe të të nxënit, përmes zhvillimit të orëve mësimore të hapura <sup>51</sup> .								
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.	Nga shqyrtimi i jetëshkrimeve profesionale të stafit të angazhuar në këtë program studimi, konstatohet se personeli akademik është i kualifikuar dhe me përvojë të përshtatshme për përgjegjësitë e veçanta të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit <sup>52</sup> . Nga bisedat e realizuara edhe me studentët, u konstatua se metodat e mësimdhënies janë me në qëndër studentin, si edhe orët mësimore zhvillohen përmes përdorimit të teknikave të ndryshme të mësimdhënies, si diskutim, hartim dhe prezantim detyrash dhe projektsh kursi <sup>53</sup> , etj.								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Stafi akademik nxitet të marrë pjesë në aktivitete të shumta të tilla si prezantimi i orëve të hapura, i tryezave të rumbullakëta, ose edhe në konferenca të ndryshme shkencore <sup>54</sup> , me qëllim kryesor ndarjen e përvojave më të mira për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.2

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

<sup>50</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Programet lëndore (Syllabuset)", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>51</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.18, Shembull i orëve të hapura", ASCAL, Dok. nr.60. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>52</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.8, Jetëshkrimet e Stafit të përfshirë në programin e studimit", ASCAL, Dok. nr.38. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>53</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.27, Model detyre, projekt\_studentor", ASCAL, Dok. nr.67. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>54</sup> Uniko. "Konferenca Shkencore: Gjithëpërfshirja në veprim", gjendet në: <http://www.unikorcedu.al/sq/content/uniko-zhvilloi-konferenc%C3%ABn-studentore-me-tem%C3%AB-%E2%80%9Cgjith%C3%ABp%C3%ABrshirja-n%C3%AB-veprim%E2%80%9D-0>

<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Për shkak të situatës së krijuar si rezultat i efektit të Pandemisë Covid-19, grupi i ekspertëve të jashtëm nuk pati mundësi që të shihte në prezencë fizike hapësirat ku zhvillohet procesi mësimor-laboratorik. Megjithatë, nga stafi i UNIKO-s u mundësua që të vëzhgoheshin me kamera të gjitha ambjentet. Nga këto vëzhgime, u konstatua se hapësirat e realizimit të procesit mësimor, pranë FEF, janë të mjaftueshme dhe cilësore dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar, u konstatua që UNIKO ka një sistem funksional operimi Moodle ESSE3<sup>55</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga analiza e syllabuseve të lëndës, u konstatua se për çdo syllabus kishte literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse. Kjo literaturë ishte në dispozicion të studentëve si në formatin fizik në bibliotekë, ashtu dhe në formatin elektronik. Nga shqyrtimi i syllabuseve u konstatua se literatura e detyruar, jo gjithmonë ishte e pesë viteve të fundit.</p> <p><i>Rekomandohet që të ketë një rishikim të literaturës bazë duke mundësuar futjen e titujve të pesë viteve të fundit, për të përmbushur dhe detyrimin e akteve nënligjore në fuqi<sup>56</sup>.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në këtë kuadër, UNIKO ka mundësuar shfrytëzimin e librarisë on-line “U-Library”, e cila siguron një tjetër mundësi për përditësimin dhe përmirësimin e materialeve mësimore që u vihen në dispozicion studentëve dhe pedagogëve.<sup>57</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike</p>	<p>Nga vëzhgimet online në institucion u konstatua që FEF kishte infrastrukturën e nevojshme për të realizuar objektivat mësimore të programit Me karakter profesional “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”.</p>

<sup>55</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.6, Manual i Sistemit Elektronik ESSE3", ASCAL, Dok. nr. 8. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>56</sup> VKM Nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”

<sup>57</sup> UNIKO, <http://www.unkorce.edu.al/sq/content/biblioteka-digjitale-u-library-sh%C3%ABrbim-i-ri-n%C3%AB-uniko?page=7>

shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Studenti mund të punonte për realizimin e detyrimeve lëndore apo të programit, ose në bibliotekë, ose në sallat e informatikës, të cilat ishin të pajisura me softëare të përshtatshëm.			
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Si në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, edhe në UNIKO mësimi përgjatë vitit 2020 po zhvillohet përmes përdorimit të platformave të dedikuara të mësimdhënies për mësimin online, siç është platforma Microsoft Teams. Nga bisedat e realizuara me stafin e UNIKO, u konstatua se si stafi akademik ashtu dhe studentët kishin marrë trajnime për zhvillimin e kompetencave të tyre digjitale, në mënyrë që ky proces të realizohej sa më cilësisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Institucioni UNIKO ka efektiv në nivelin e funksionimit Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë <sup>58</sup> . Gjatë bisedës me stafin e këtij komisioni, si edhe nga dokumentacioni i paraqitur nga UNIKO, u konstatua që ky komision vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore dhe propozon ndryshime në funksion të rritjes së cilësisë së gjithë procesit.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Përcaktuar edhe nga Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, Departamenti që ofronte programin e studimit ishte përgjegjës edhe për gjithë cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të të nxëniet që ai ofronte. Njësia bazë merrej si me formën ashtu dhe me përmbajtjen e të gjithë procesit, duke garantuar që mësimi të zhvillohet nga

<sup>58</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.5.1, Plani i punës së Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë së Kërkimit Shkoncor", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	personel akademik me ekspertizën dhe kualifikimin e duhur. <sup>59</sup>			
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Nga biseda me stafin akademik të FEF-DE përgjegjës për realizimin e këtij programi studimi, u konstatua se ky staf kishte kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me literaturë bashkëkohore. Gjithashtu, aplikimi i lirisë akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave të studentëve i krijonte mundësi pedagogut që të aplikonte në auditor forma të mësimdhënies dhe të nxëniet të cilat zhvillonin proceset e mendimit kritik dhe atij krijues.			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre.	Nga shqyrtimi i syllabuseve konstatohet që personeli akademik ka të evdidentuar metodologjinë që duhet të përdorë për të aplikuar metodat inovative në procesin mësimor. Gjithashtu, nga bisedat e zhvilluara me stafin e IT, u konstatua se në fillim të vitit akademik 2020-2021 ishin realizuar trajnime për përmirësimin e kompetencave digjitale të stafit.			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Siç u theksua edhe më sipër, personeli akademik në UNIKO-FEF-DE ka autonominë e zgjedhjes dhe të përdorimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe mund të ndikojë që ndryshimet e duhura pozitive të pasqyrohen në periudhën e rishikimit vjetor të syllabuseve. Përvoja vetjake transmetohej në mbledhjet e departamentit, apo në orët e hapura që janë zhvilluar nga stafi akademik, duke synuar që metodat e përparuara dhe me ndikim pozitiv të ndiqen dhe të shfrytëzohen edhe nga kolegët e tjerë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi III.4

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.**

<sup>59</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.18, Shembull i orëve të hapura", ASCAL, Dok. nr.60. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Institucioni UNIKO-FEF-DE, ka hartuar dhe miratuar dokumente rregullatore transparente<sup>60</sup> që normojnë kriteret, mënyrën e vlerësimit, si edhe njohjen e tyre prej studentëve. Studentët njihen me procedurat e mësipërme nga titullari i lëndës gjatë momentit të prezantimit të syllabusit. Gjithashtu, studentëve u mundësohet në mënyrë të vazhdueshme edhe ndihma e ofruar nga Koordinatorit i programit të studimit<sup>61</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në Kurrikulën e programit të studimit, si edhe në Rregulloren e programit të studimit, parashikohen forma të ndryshme të vlerësimit të dijeve, duke i dhënë mundësi pedagogut të lëndës që të zgjedhë ato metoda që i përshtaten një lënde të caktuar që janë më të përshtatshme për të evidentuar rezultatet e të nxënit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Referuar paketës së syllabuseve që institucioni ka dorëzuar, si edhe nga bisedat e zhvilluara me studentët e programit me karakter profesional “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”, konstatohet se pedagogët që mbulojnë disiplinat e këtij programi kanë të pasqyruara qartë në syllabuse dhe informojnë studentët për formatet e procesit të vlerësimit të vazhduar dhe të vlerësimit përmblendhës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në institucionin UNIKO në kuadër të bashkëveprimit me projektin “CleanScore”, është mundësuar përdorimi i zhvillimit të platformave elektronike për korrigjimin e testeve që më pas pasqyrohen dhe në sistemin ESSE3. Nga shqyrtimi i syllabuseve u konstatua se ishte në politikën e institucionit vlerësimi i përgatitjes akademike në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit shkollor përmes kuizeve të ndërmjetme, nivelit të diskutimeve në seminare, detyrave të kursit (ese, prezantime, projekte), detyrave praktike, si edhe provimit përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi,</p>	<p>Procedurat e vlerësimit rezultojnë të jenë transparente. Gjithashtu, stafi akademik realizon vlerësim të arsyetuar të të gjithë komponentëve të parashikuar në detyrimet</p>

<sup>60</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional” Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”, ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>61</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.9, Vendim i Njësisë Bazë për Emërimin e Koordinatorit të Programeve të Studimit", ASCAL, Dok. nr.39. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	akademike. Nga bisedat me stafin akademik në kuadër të këtij procesi, pedagogët realizojnë edhe seancat sqaruese me studentët, ku këta të fundit marrin edhe komente të ndryshme lidhur me vlerësimin e kryer.								
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	Nga bisedat e organizuara me stafin dhe studentët, u konstatua se përmes sistemit online MOODLE ESSE3, studenti informohet brenda afateve të përcaktuara nga institucioni për rezultatet e provimit. Gjithashtu, pedagogët përcaktojnë orare për seancat sqaruese me studentët <sup>62</sup> .								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				X
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			X						

### Standardi III.5

**Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përftimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.	Programi i studimit të ciklit të dytë me karakter profesional "Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", është organizuar në mënyrë të tillë që çdo student të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale me qëllim punësimin ose kualifikimin e mëtejshëm të tij. Në këtë program, të shprehura edhe në kurrikulën e programit dhe gjithashtu edhe në të gjitha syllabuset e lëndëve, janë të përfshira dijet dhe aftësitë profesionale që duhet të fitojnë studentët dhe që janë në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohet ky program. <sup>63</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Programi i studimit synon të formojë edukatorë për çerdhet dhe që janë kompetentë për edukimin në foshnjëri dhe në fëmijërinë e hershme. Duke qënë se vetë programi i studimit është një program i fushës sociale dhe që prek

<sup>62</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.32, Shembull Seance Konsultimi ", ASCAL, Dok. nr.74. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>63</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>komunikimin dhe ndërveprimin, programi ka të ndërthurur në kurrikulën e tij të gjithë këta elementë.<sup>64</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në funksion të këtij programi studimi, FEF-DE kishte funksionalë dy laboratorë që mundësonin zbatimin praktik të njohurive teorike të marra nga studentët. Kështu, "Laboratori i Foshnjërisë dhe i Fëmijërisë së Hershme", i ngritur në mjediset e Rektoratit me bazën materiale të disponueshme, mundëson në mënyrë praktike realizimin e kompetencave kyçe të programit. Gjithashtu, "Laboratori për zhvillimin profesional" është i dedikuar për veprimtaritë të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me zhvillimin në foshnjëri dhe në fëmijërinë e hershme. Nga bisedat me stafin u konstatua se UNIKO ishte në proces për ndërtimin e bashkëpunimeve të reja për të mundësuar mobilitetin e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve<sup>65</sup> u konstatua se organizimi i disiplinave është i tillë që lejon, si pedagogët ashtu dhe studentët, që të bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara dhe duke mundësuar marrjen e mendimit të studentëve lidhur me atë se çfarë mund të përmirësohet në vazhdim. Stafi akademik ishte në dispozicion të studentëve për të përforcuar procesin njohës, analizues, krijues, si edhe gjykues gjatë të nxënimit për konceptet e ofruara nga disjplinat e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo</p>	<p>Programi me karakter profesional "Edukimi për Fëmijërinë dhe Foshnjërinë e Hershme", ka si provë finale për procesin e diplomimit ose provimin e përgjithshëm përfundimtar, ose një punim diplome, me 4 ECTS. Bazuar në Rregulloren Mësimore, DE harton procedura të përshtatshme për studentët të cilët japin ose provimin final,<sup>66</sup> ose mbrojnë diplomën. Nga vëzhgimet e kryera pranë sekretarisë mësimore të UNIKO, institucioni dispononte rekorde të plota mbi numrin e studentëve të diplomuar.</p>


<sup>64</sup> Ibid

<sup>65</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Programet lëndore (Syllabuset)", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>66</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.33, Model Teze Provimi Formimi", ASCAL, Dok. nr.75. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

viti akademik.				
<b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	Në vitin akademik 2019 -2020 ky program studimi diplomoi brezin e parë të studentëve. Siç konstatohet edhe nga RVB, duke qënë se në pranverën e vitit 2020 i gjithë vendi ju nënshtrua kushteve të reja të bashkëjetesës me Covid-19, nuk kishte mundësi që studentët të realizonin punim diplome. Por Institucioni ka gjithë kapacitetet e duhura që të orientojë dhe të udhëheqë studentët për provimin e diplomës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB<sup>67</sup> dhe takimi online me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore konstatuam që institucioni zbaton procedura ligjore për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e e programit të studimit.</p> <p>DE në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit harton procedurat për shpalljen e thirrjes online, përgatitjes së komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara të baza ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të rregullores së UNIKO<sup>68</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ të</p>	<p>Nga takimi virtual me Përgjegjësen e Departamentit të Edukimit konstatuam se vetë departamenti përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, formularin e organizimit të kohës vjetore, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore<sup>69</sup>.</p> <p>Nga ana tjetër Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit<sup>70</sup> administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DE. Ajo arkivon dosjet përkatëse të personelit akademik, si dhe të marrëveshjeve të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit<sup>71</sup>.</p>

<sup>67</sup> UNIKO, FEF, DE, "RVB – PP- EFFH 2020", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>68</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.13, Udhëzim për rekrutimin e stafit akademik", ASCAL, Dok. nr: 17. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>69</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.14, Udhëzim për përmbajtjen e dosjes së stafit", ASCAL, Dok. nr: 18. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>70</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.4, Rregullore e Drejtorisë së burimeve Njerëzore", ASCAL, Dok. nr: 5. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>71</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca shtese 2 "Dosja e stafit", ASCAL, Dok. nr: 93. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




angazhuar.									
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Institucioni dhe DE dëshmojnë të kenë burimeve njerëzore të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit me karakter profesional “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme” <sup>72</sup> dhe mjedise të përshtatshme për krijimin mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale <sup>73</sup> .								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Konstatohet se institucioni është angazhuar para por edhe gjatë periudhës së pandemisë për kualifikimin e vazhdueshëm <sup>74</sup> dhe zhvillimin profesional të personelit për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja si platforma Microsoft Teams <sup>75</sup> , si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik <sup>76</sup> , përgjegjës për programin e studimit të EFFH <sup>77</sup> .								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me**

<sup>72</sup> UNIKO, FEF, DE, Dokument shtesë 1.b. Lista e stafit të angazhuar në programin e studimit PAK PAE PP EFFH. Ascal, dok. Nr:77. Parë në dhjetor 2020, gjendet <https://ascal.al/sq>.

<sup>73</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.8, Jetëshkrimet e Stafit të përfshirë në programin e studimit", ASCAL, Dok. nr:38. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>74</sup> UNIKO, FEF, DE, Trajnimi i stafit. Ascal, dok. Nr:77. Parë në dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>75</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.16, Model Mësimi on-line Office 365", ASCAL, Dok. nr:65. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>76</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.7, Analiza vjetore e njësisë bazë", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>77</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Tabela përmbledhëse për RVB" Tabela 19, ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<b>karakter profesional</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita virtuale e mjediseve të institucionit konstatojmë se programi me karakter profesional "EFFH" realizohet në dy godina të Kampusit të UNIKO-s: në Fakultetin e Edukimit dhe në Rektorat <sup>78</sup> . Laboratori për zhvillimin profesional <sup>79</sup> në mjediset e Rektoratit ishte i përshtatshëm, i pajisur me mjetet e nevojshme didaktike, për të zhvilluar veprimtaritë mësimdhënëse teorike dhe praktike. Laboratori është krijuar në funksion të mësimdhënies të programit EFFH në bashkëpunim me Universitetin e Bolonjës, Itali <sup>80</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Fakulteti i Edukimit disponon hapësira komode për akomodimit të studentëve <sup>81</sup> . Sipas Raporti të Vlerësimit Vjetor nga MARS kapacitetet e kapacitetet pritëse për programin e studimit EFFH përmbushin standardet e meritave katrorë për student <sup>82</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita virtuale e mjediseve konstatojmë se auditorët mësimorë janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banka, karrike, pajisje audiovizive, tabela etj.). Sallat e leksioneve në të cilat zhvillohen modulet e programit të studimit EFFH janë të pajisura me videoprojektorë. Laboratori i ngritur në mjediset e Rektoratit në mbështetje të programit të studimit EFFH zotëron një sërë mjetesh dhe pajisjesh didaktike të cilat shfrytëzohen nga studentët për të kryer veprimtari të shumëllojshme në orët laboratorike <sup>83</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me	Nga shqyrtimi i RVB konstatojmë se laboratori i informatikës është i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që të t'i shërbejë sa më mirë programit mësimor.

<sup>78</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit – Kapacitet infrastrukturor", ASCAL, Dok. nr:81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>79</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.28, Laboratori EFFH R22", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>80</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.10, Marrëveshje bashkëpunimi në Mbështetje të Programit të Studimit", ASCAL, Dok. nr:40 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>81</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Tabela përmbledhëse për RVB" Tabela 16, ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>82</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.15, Raporti i kontrollit të MASR për kapacitetet pritëse të UNIKO", ASCAL, Dok. nr: 19. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>83</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.28, Laboratori EFFH R22", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



<p>programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Ai është në parametra të mira për realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Infrastruktura e laboratorit vihet në dispozicion të orëve me karakter praktik në të gjitha modulet e programit të EFFH. Laboratori, gjithashtu, shërben edhe për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme nga vetë departamenti apo për veprimtari intershipi me institucione dhe subjekte të tjera me të cilat Uniko ka marrëveshje bashkëpunimi për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e këtij program studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme karakter profesional.</p>	<p>Institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Departamentin e Shkencave të Edukimit të Universitetit të Bolonjës, Itali për hartimin dhe zhvillimin e kurrikulës, për krijimin e mjedisve infrastrukturore, për shkëmbim eksperiencash ndërmjet studentëve dhe stafit akademik<sup>84</sup>. Gjithashtu institucioni ka realiuar marrëveshje bashkëpunimi me OJQ Save the Children dhe me Bashkinë e Korçës<sup>85</sup> për krijimin e kushteve për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike të cilat janë thelbësore për këtë program studimi<sup>86</sup>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e</p>	<p>Konstatuam se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve për programin e studimit EFFH fondin e librave që ndodhen në Bibliotekën “Kongresi i Manastirit” në FEF dhe Biblioteka Shkencore në Rektorat. Studentët kanë të drejtë të regjistrohen të përdorin literaturën e nevojshme në mjediset e bibliotekave si të</p>

<sup>84</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.10, Marrëveshje bashkëpunimi në Mbështetje të Programit të Studimit", ASCAL, Dok. nr:40 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>85</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.24, Veprimtari në kuadër të marrëveshjes me Bashkinë e Korçës", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>86</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.10, Marrëveshje bashkëpunimi në Mbështetje të Programit të Studimit", ASCAL, Dok. nr:40 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>tërheqin gjithashtu literaturë për shfrytëzim jashtë mjediseve të bibliotekës<sup>87</sup>. Biblioteka në FEF ka 52 vende ulëse dhe një pjesë e tavolinave janë të pajisura me kompjutera dhe internet. <i>Konstatuam nga personi përgjegjës i bibliotekës se FEF, se numri i studentëve të regjistruar në bibliotekë është relativisht i vogël.</i></p> <p>Ndërsa nëpërmjet bibliotekës online: EBSCO<sup>88</sup>, studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë literaturën e nevojshme për zhvillimin dhe pasurimin e njohurive teorike dhe realizimin e punëve laboratorike që ofrohen nëpërmjet moduleve të këtij program studimi.</p> <p>Studentëve u vihet gjithashtu në dispozicion fondi i librave të DE të cilët pedagogët e shfrytëzojnë drejtpërdrejt si literaturë bazë ose mbështetëse në hartimin e programeve lëndore e cila gjithashtu gjendet në platformën ESSE3.</p> <p>Rezulton se fondi i librave është krijuar vit pas viti si rezultat i dhurimeve të ndryshme të bëra nga shtëpitë botuese në vend dhe blerjeve të kryera në kuadër të bashkëpunimit që DE ka pasur me organizata joqeveritare<sup>89</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi virtual me Drejtorinë e Bibliotekës rezultoi se biblioteka ka në dispozicion një fond librash me 2600 tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj. 9 tituj prej tyre janë libra dedikuar programim profesional EFFSH për realizimin e veprimtarive mësimore sipas moduleve të ofruara.</p> <p><i>Fondi i librave i deklaruar nga institucioni në funksion të këtij program studimi është shumë i vogël, vetëm 9 tituj<sup>90</sup>.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës,</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB rezultoi se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën online: EBSCO dhe Scopus pa pagesë<sup>91</sup>. Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë literaturën e nevojshme për zhvillimin dhe pasurimin e njohurive teorike dhe realizimin e punëve laboratorike që ofrohen nëpërmjet moduleve të këtij program studimi.</p>

<sup>87</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.5, Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe të kërkimit shkencor. Neni 16-23", ASCAL, Dok. nr: 6. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>88</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Tabela përmbledhëse për RVB" Tabela 17, ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>89</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.35, Akt dhurimi për bibliotekën", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>90</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1, "Fondi i librave në funksion të programit të studimit", ASCAL, Parë në Janar 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>91</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Tabela përmbledhëse për RVB" Tabela 17, ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	Nga takimi virtual me stafin akademik dhe studentët konstatuam se studentëve u vihet gjithashtu në dispozicion fondi i librave të DE të cilin pedagogët e shfrytëzojnë si literaturë bazë në programet e moduleve që zhvillojnë. Fondi i cili është krijuar vit pas viti si rezultat i dhurimeve të ndryshme të bëra nga shtëpitë botuese në vend dhe blerjeve të kryera në kuadër të bashkëpunimit që DE ka pasur me organizata joqeveritare <sup>92</sup> . Në vitin 2019 institucioni ka krijuar një sistem digjital të brendshëm të menaxhimit "ESSE3" <sup>93</sup> . Ky sistem elektronik administron materialet e hedhura nga stafi akademik për lëndët dhe modulet e ndryshme, materialet shtesë, pikët dhe vlerësimet e studentëve.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	Institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar <sup>94</sup> i cili miratohet nga Senati akademik dhe Bordi i Administrimit, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i tarifës së shkollimit <sup>95</sup> . Të ardhurat për mbarëvajtjen e programit të studimit burojnë nga buxheti i shtetit dhe nga tarifa e studentëve.  <i>Institucioni nuk ka paraqitur një plan financiar për mbështetjen dhe mbarëvajtjen financiare të programit të studimit EFFH.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare	Plani financiar i programit të studimit profesional EFFSH miratohet në nivel institucional nga Bordi i Administrimit, në të cilin përfshihen të gjitha kostot dhe të ardhurat e programit <sup>96</sup> . Bordi në komunikim me departamentin vendos për përcaktimin e tarifës së shkollimit.

<sup>92</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.35, Fond i Bibliotekës, Akt Dhurimi për Bibliotekën", ASCAL, Dok. nr:84 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>93</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.6, Manual i Sistemit Elektronik ESSE3", ASCAL, Dok. nr: 8 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>94</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.8.1, Rregullorja Financiare", ASCAL, Dok. nr: 12. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>95</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.8, Rregullore e Drejtorisë Financiare", ASCAL, Dok. nr: 11 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>96</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.32, Shembull Seance Konsultimi ", ASCAL, Dok. nr:74. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Konstatohet që institucioni harton, zbaton dhe bën publike procedura dhe kritere të qarta për pranimit e studentëve. Mbështetur në praktikën e miratimit të kritereve të pranimit të Uniko për programin e studimit me karakter profesional EFFH, kriteri i vëtem për pranimin e studentëve është të kenë përfunduar Arsimin e Mesëm të Lartë. <sup>97</sup> Institucioni gjithashtu harton dhe zbaton objektiva të qarta për përparimin dhe vlerësimin e dijeve <sup>98</sup> të studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet ligjore që derivojnë prej tij, të cilat sigurojnë shance të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë sipas kategorive përkatëse, përfshirë edhe kuota për kandidatë nga shtresa në nevojë <sup>99</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.	Rezulton se institucioni harton dhe miraton çdo fillim akademik kritere të përgjithshme dhe të veçanta për çdo program studimi për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, pastaj i bën ato publike pas miratimit nga MARS për kandidatët e interesuar. Në fillim të vitit akademik e në vazhdim studentët informohen periodikisht mbi procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimet e studimeve dhe mobilitetin, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtaritë akademike, kulturore, njoftime etj., nëpërmjet "Katalogut të Studimeve" <sup>100</sup> .

<sup>97</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.9, Praktika e miratimit të kritereve të pranimit", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>98</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", ASCAL, Dok. nr:33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>99</sup> UNIKO, FEF, DE, Dokument shtese 7., Vendim Senati kuotat për tre vite. Parë në dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>100</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.6, Katalogu i studimeve", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Rezulton se pranimi i studentëve në programin e studimit Profesional "EFFH" kryehet sipas kriterëve të përcaktuara nga institucioni dhe miratuar nga MARS<sup>101</sup>. Procesi i regjistrimit kryhet sipas procedurave dhe afateve të shpallura nga MASR nga sekretaritetë mësimore<sup>102</sup>. Ndërsa çdo procedurë tjetër që lidhet me kuota dhe kriterë transferimi dhe diplomimi miratohen si pjesë e rregullores së programit të studimit dhe iu bëhet e ditur studentëve të interesuar<sup>103</sup>. Ndërkohë informacioni lidhur me sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura përcaktohen gjithashtu edhe në strukturën e vitit akademik<sup>104</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve,</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe takimi online u informuam se DE në fillim të vitit të parë të studimeve organizon një takim informues me studentët e rinj<sup>105</sup> gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës, leximin e orarit mësimor dhe përdorimin e sistemit informativ ESSE3. "Udhërrëfytyesi i Studentit"<sup>106</sup>, dëshmon se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet ESSE3. Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me kurrikulën e programit të studimit, lëndët/modulet dhe ngarkesat përkatëse, syllabuset dhe format e vlerësimit për secilën, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve</p>	<p>Konstatohet se çdo fillim viti akademik institucioni vë në dispozicion të studentëve strukturën e vitit akademik<sup>107</sup> e cila</p>

<sup>101</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.9, Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>102</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.10, Rregullore e sekretarisë mësimore ", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>103</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", ASCAL, Dok. nr:33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>104</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.26, Struktura e Vitit Akdemik", ASCAL, Dok. nr:68 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>105</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.11, Praktika e informimit te studenteve me programin e studimit", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>106</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.37, Udhërrëfytyesi i studenteve", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>107</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.22, Te dhena nga plani i financimit te studimit ", ASCAL, Dok. nr:77. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>përcjell veprimtaritë kalendarike mësimore dhe Katalogun e Studimeve për programin e studimit EFFH<sup>108</sup>, i cili është një udhëzues specifik për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese, orët, kreditet dhe informacion të gjerë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Rezulton se institucioni nëpërmjet sistemit informativ ESSE3<sup>109</sup> përcjell informacionin në distancë tek studentët dhe nëpërmjet përdorimit të platformës Microsoft Teams zhvillon leksionet online dhe përcjell informacionin e nevojshëm për realizimin e moduleve teorike dhe praktike.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>UNIKO përdor sistemin digjital ESSE3 dhe menjëherë pas shpalljes së pandemise globale të Covid-19 ka vënë në përdorim për zhvillimin dhe administrimin e informacionit pëkundrejt studentëve platformën Microsoft Teams Office 365<sup>110</sup>.</p> <p>Në bazë të Manualit të këtij programi ESSE3 rezulton se institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata të</p>

<sup>108</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.36, Katalogu i studimeve", ASCAL, Dok. nr:77. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>109</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.6, Manual i Sistemit Elektronik ESSE3", ASCAL, Dok. nr: 8 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>110</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.6, Manual i Sistemit Elektronik ESSE3", ASCAL, Dok. nr: 8 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti.</p> <p>Gjithashtu konsatuam që sekretaria mësimore e FEF disponon statistika vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit<sup>111</sup>;</li> <li>• të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik;</li> <li>• të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet;</li> <li>• të dhëna për ecurinë akademike të studentit;</li> <li>• numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik,</li> <li>• si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen<sup>112</sup>.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në Raportit Vjetor të Veprimtarisë së DE<sup>113</sup> rezulton se insitucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik.</p> <p>Ndërsa në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm<sup>114</sup> shpehet qartë aktiviteti që insitucioni ka, në rang njësie kryesore dhe njësie bazë me partnerët të cilët janë të angazhuar në realizimin e këtij program studimi siç janë: Departamenti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Bolonjës, Itali; OJQ Save the Children; Bashkia Korçë, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi virtual me sekretarinë mësimore konstatuam se ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në ESSE3 dhe në formatin e Regjistrat Themeltar të Studentëve dhe Regjistrin e Diplomimit. Çdo e dhënë koordinohet me sistemin qendror kombëtar dhe studenti regjistrohet përfundimisht vetëm pasi i njihet numri i matrikullimit<sup>115</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe</p>	<p>Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa e-mail-i dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti ruhen nga sistemi në mënyrë diskrete dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat IT të autorizuar në fakultet dhe rektorat.</p>

<sup>111</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit – Tabela 21", ASCAL, Dok. nr:81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>112</sup> UNIKO, FEF, DE, Dokument shtese 5., Mesatarja në dalje. Parë në dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>113</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.7, Analiza vjetore e njësisë bazë", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>114</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.6, Raporti vjetor i NjsBC - FEF", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>115</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.10, Rregullore e sekretarisë mësimore ", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

studentëve.				
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Raportit i Vlerësimit të Brendshëm <sup>116</sup> dhe Raportit Vjetor i Veprimtarisë së DE <sup>117</sup> dëshmon se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ nëpërmjet aksesit që i jep dekanit dhe përgjegjësit të departamentit të kontrollojnë hedhjen në kohë të dokumentacionit të këkuar, përbushjen e zhvillimit të lekioneve online nëpërmjet patformës Microsoft Teams dhe kritereve të vlerësimit dhe respektimit të afateve të hedhjes së rezultateve online në platformën ESS3 <sup>118</sup> .			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Konstatojmë se në faqen zyrtare të internetit të UNIKO janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe planet mësimore si dhe kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftime të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UNIKO, në gjuhën shqipe <sup>119</sup> .			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<sup>116</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.6, Raporti vjetor i NjSBC - FEF", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>117</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.7, Analiza vjetore e njësisë bazë", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>118</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.6, Manual i Sistemit Elektronik ESSE3", ASCAL, Dok. nr: 8 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>119</sup> <https://www.unkorce.edu.al>



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Rezulton se institucioni zbaton politika për kriteret e pranimit dhe transferimit bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ne Udhëzim Nr.15, datë 26.05.2020, Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar si dhe Udhëzim Nr. 17, datë 30.07.2019, Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Gjithashtu institucioni bazohet tek propozimet e bëra nga njësitë bazë dhe të miratura nga Senati Akademik për kutotat dhe kriteret<sup>120</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përpapa fillimit të çdo viti akademik institucioni me propozim nga DE dhe miratim nga Senati Akademik dhe MARS<sup>121</sup>, harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit EFFH, duke garantuar shance të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare ashtu dhe personat me aftësi të veçanta, etj. Kriteret e pranimit dhe kuotat për secilin program studimi publikohen nga UNIKO si dhe materiale udhëzuese për studentët<sup>122</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe,</p>	<p>Rezulton se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UNIKO, sipas legjislacionit në fuqi, dhe i publikon ato online në faqen: <a href="http://eeë.unkorce.edu.al/">eeë.unkorce.edu.al/</a> për secilin program studimi. Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA) ka hartuar politika të</p>

<sup>120</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.9, Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>121</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.9, Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>122</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.37, Udhërrefyesi i studenteve", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që Uniko ofron<sup>123</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet online konstatuam se institucioni publikon në faqen e tij të internetit procedurat që duhet të ndjekin maturantët të cilët dëshirojnë të regjistrohen në programet e studimit që ofron UNIKO si dhe procedurat për transferimin e studimeve, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve, diplomimin e studentëve. Çdo infomacion i publikuar online rreth kriterëve dhe përparimit akademik gjendet edhe në rregulloren e programit të studimit të EFFH<sup>124</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale udhëzuese si Udhërrëfyese i Studentit<sup>125</sup> dhe Rregullorja e Programit të Studimit të EFFH<sup>126</sup> si dhe syllabuset<sup>127</sup> e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës, ku janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit me karakter profesional.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit të EFFH<sup>128</sup> dëshmon se përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura përcaktohen gjithashtu edhe në Strukturën e Vitit Akademik<sup>129</sup> dhe si të tilla ruhen në sistem dhe u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon</p>	<p>Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit dhe kuotat për secilin program studimi.</p>

<sup>123</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.10, Praktika e promovimit dhe informimit të maturantëve", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>124</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", ASCAL, Dok. nr:33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>125</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.37, Udhërrëfyese i studentëve", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>126</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", ASCAL, Dok. nr:33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>127</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Programet lëndore (Syllabuset)", ASCAL, Dok. nr:35 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>128</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", ASCAL, Dok. nr:33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>129</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.26, Struktura e Vitit Akademik", ASCAL, Dok. nr:68 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Përpara pandemisë globale të Covid-19, në kuadër të ditëve të hapura për maturantët Uniko organizonte me shkollat e mesme të larta në vend takime informuese rreth UNIKO dhe programeve të studimit që ai ofron.</p> <p>Nga vizita virtuale e mjedise edhe pse për shkak të masava anti Covid nga Komiteti Teknik mungonin studentët në institucion, në këndet e njoftimeve përkatëse të fakultetit gjendeshin të afishuara njoftimet për kalendarin mesimor dhe ecurinë e programit të studimit.</p> <p>Në faqen e internetit të UNIKO gjendet në çdo kohë "Udhërrëfyese i studentëve"<sup>130</sup>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Rezulton se programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të afishuara në këndet përkatëse të fakultetit, pranë departamenteve, në mjedise publike dhe gjithashtu gjenden edhe në faqen e internetit të UNIKO sipas fakulteteve përkatëse.</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• si Udhërrëfyese i Studentit<sup>131</sup> ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UNIKO-s dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.</li> <li>• Rregullorja e Programit të Studimit të EFFH<sup>132</sup> përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga</li> </ul>

<sup>130</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.37, Udhërrëfyese i studenteve", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>131</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.37, Udhërrëfyese i studenteve", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>132</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", ASCAL, Dok. nr:33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>njëri vit në tjetrin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• syllabuset<sup>133</sup> e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në vecanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit me karakter profesional.</li> <li>• Strukturën e vitit akademik<sup>134</sup> në të cilën përcaktohen datat e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura, diplomimet.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit dhe Rregullorja e programit të studimit EFFH<sup>135</sup> dëshmonjë se janë të përcaktuara qartë orët laboratorike profesionale që zhvillohen në semestrin e dytë dhe të katërt me kreditet përkatëse dhe përshkrimin e detajuar.</p> <p>Për realizimin e praktikës për studentët e këtij programi studimi është nënshkruar Marrëveshja midis UNIKO dhe Bashkisë Korçë<sup>136</sup>, ku përshkruhet angazhimi që do të marrë institucioni i bashkisë, si institucioni që ka në varësi çerdhet publike, për lehtësimin e zhvillimit të praktikave të studentëve të UNIKO, të cilët ndjekin programin e studimit EFFH.</p> <p>Nga shqyrtimi i RVB rezultojnë se në fillim të vitit akademik sekretaria e departamentit u komunikon studentëve kohën e kryerjes së praktikës profesionale dhe programin e saj. Praktikën profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti i edukimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Përpara pandemisë globale të Covid-19, çdo fillim të vitit të parë të studimeve DE organizonte një takim informues me studentët e rinj gjatë së cilës orientoheshin me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës, leximin e orarit mësimor dhe përdorimin e sistemit informativ ESSE3<sup>137</sup>.</p> <p>Nga vizita virtuale e mjedise edhe pse për shkak masave anti Covid studentët nuk ishin prezent, konstatojmë se në këndet e</p>

<sup>133</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Programet lëndore (Syllabuset)", ASCAL, Dok. nr:35 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>134</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.26, Struktura e Vitit Akademik", ASCAL, Dok. nr:68 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>135</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional" Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme", ASCAL, Dok. nr:33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>136</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.10, Marrëveshje bashkëpunimi në Mbështetje të Programit të Studimit", ASCAL, Dok. nr:40 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>137</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.6, Manual i Sistemit Elektronik ESSE3", ASCAL, Dok. nr: 8 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>njoftimeve përkatëse të fakultetit ishin të afishuara njoftimin e kalendarit mesimor si dhe harta orientuese e godinës.</p> <p>Në faqen e internetit të UNIKO gjithashtu gjendet i publikuar "Udhërrëfyesi i studentëve"<sup>138</sup> ku studenti mund të gjejë informacion të plotë për strukturat e UNIKO-s dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Rezulton se nëpërmjet sistemit digjital ESSE3<sup>139</sup>, i cili menaxhon dhe administron informacionin dhe aktivitetin e personelit akademik duke publikuar online kurrikulat e studimit, monitoron planet mësimore, regjistron në sistem stafin akademik që mbulon lëndën/modulin dhe atë ndihmës mësimor, raporton mbi ecurinë e plotësisht të afateve të përcaktuara si dhe nëpërmjet platformës Microsoft Teams për zhvillimin e leksioneve online studentët, siç pohuan edhe vetë studentët gjatë takimit online të zhvilluar në Zoom, arrijnë të marrin informacion lehtësisht edhe në distancë dhe të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Analizës Vjetore të UNIKO kostatojmë se institucioni çdo vit akademik, paraqet pranë MASR-së raportet vjetore për veprimtarinë e kryer<sup>140</sup>.</p> <p>Raporti përmban informacione, përveç të tjerash edhe për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që Uniko ofron.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe Rregullorja e Sekretarisë Mësimore<sup>141</sup>, rezulton se sekretaria mësimore është zyra e cila</p>

<sup>138</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.37, Udhërrëfyesi i studentëve", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>139</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.6, Manual i Sistemit Elektronik ESSE3", ASCAL, Dok. nr: 8 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>140</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.19, Analiza Vjetore UNIKO", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>141</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.10, Rregullore e sekretarisë mësimore", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët. Sekretaria Mësimore disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalje<sup>142</sup> etj. Nga takimi online me sekretarinë mësimore konstatoam se ajo administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Nga takimi online me përfaqësues të Qendrës së Karrierës dhe Alumnit konstatoam se ajo mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre<sup>143</sup>. Ajo ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga takimi virtual rezultoi se sekretaria mësimore e FEF disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik, transferimet dhe rregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen, përfshi edhe temën e diplomimit<sup>144</sup>. Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në Programin Digjital të Sistemit Universitar ESSE3. Rruajtja e regjistrimit elektronik bëhet nëpërmjet sistemit "BACK UP" nga RASH.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së</p>	<p>Nga shqyrtimi i Analizës Vjetore të UNIKO rezultoi se institucioni çdo vit akademik, paraqet pranë MASR-së raportet vjetore për veprimtarinë e kryer<sup>145</sup>. Sekretaria Mësimore gjithashtu disponon rstatistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si</p>

<sup>142</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistikore për Stafin, Studentët, Programin e Studimit Tabela ", ASCAL, Dok. nr:81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>143</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.34, Databaza Alumni PP EFFH ", ASCAL, Dok. nr:76. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>144</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.10, Rregullore e sekretarisë mësimore ", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>145</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.19, Analiza Vjetore UNIKO", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse <sup>146</sup> .  <i>Institucioni nuk paraqet nje raportin analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Konstatohet që studentët e UNIKO-s janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit: Ata kanë përfaqësues në: - Senatit Akademik <sup>147</sup> me dy anëtarë duke respektuar kutotat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. - Në Këshillin e Etikës; - Grupin e ngritur nga NJSBC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë <sup>148</sup> , akreditimit institucional dhe programeve të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete,	Rezulton që institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve në Senatit Akademik <sup>149</sup> , Këshillin e Etikës, në këshillim nëpërmjet grupit të ngritur nga NJSBC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë <sup>150</sup> , akreditimit institucional dhe programeve të studimit gjithashtu edhe në vlerësimin mbi procesin akademik nëpërmjet instrumenteve matës të ngritur <sup>151</sup> .

<sup>146</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit Tabela ", ASCAL, Dok. nr:81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>147</sup>UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.11, Rregullore e Senatit Akedemik", ASCAL, Dok. nr:15. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>148</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.5, Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe të kërkimit shkencor ", ASCAL, Dok. nr: 6. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>149</sup>UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.11, Rregullore e Senatit Akedemik", ASCAL, Dok. nr:15. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>150</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.5, Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe të kërkimit shkencor ", ASCAL, Dok. nr: 6. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>151</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.13, Model pyetsori Studentor", ASCAL, Dok. nr:55. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjithashtu një nga strukturat e ngritura në UNIKO është edhe Këshilli i Studentëve i cili funksionon në bazë të rregullores në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) të cilët kanë hartuar dhe miratuar në vitin 2017<sup>152</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Rezulton se intitucioni gjatë hartimit të programit të studimit me karakter profesional EFFH ka respektuar Ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM nr. 41/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, duke iu përmbajtur ngarkesës mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, jo më shume se 25 orë mësimore në javë<sup>153</sup>.</p> <p>Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh nga një student me kohë të plotë, është 60 kredite ose 1500 orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë 669 orë në auditor dhe 731 orë punë të pavarur për studentët në vitin e parë, ndërsa për vitin e dytë 681 orë në auditor dhe 814 orë punë të pavarur për studentët në vitin e dytë<sup>154</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Konstatohet se studentët janë të përfshirë në komisionet e ngritura nga NJSBC<sup>155</sup> që kanë për detyrë të monitorojnë cilësinë e zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit si dhe të mbështesin punën e njësive bazë për kreditimin, hartimin e programeve të reja të studimit etj si dhe janë pjesë e GVB<sup>156</sup> për hartimin e RVB për programin e studimit të EFFH, por intitucioni nuk paraqet një dokument të plotë që të pasqyrojë reflektimet dhe kontributin e tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi</p>	<p>Nëpërmjet instrumentave matës për vlerësimin e stafit<sup>157</sup> dhe pyetësor për studentët<sup>158</sup>, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së</p>

<sup>152</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.17, Rregullorja e këshillit studentor ", ASCAL, Dok. nr: 21. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>153</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Profesional” Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”, ASCAL, Dok. nr:33. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>154</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 4, Të dhëna Statistike për Stafin, Studentët, Programin e Studimit – Tabela 10", ASCAL, Dok. nr:81. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>155</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.3 Vendimi i njesise baze per ngritjen e GVB”, ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>156</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.6, Raporti Vjetor i NJSBC”, ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>157</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.13, Model pyetësori staf akademik", ASCAL. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>158</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.13, Model pyetësori Studentor", ASCAL, Dok. nr:55. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi V.5

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Rezulton se institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet zyrave përkatëse si sekretaria mësimore, sekretariatë e departamenteve dhe Zyra e Informimit të Studentëve, Zyra e Karrierës dhe promocionit si dhe në çdo fakultet ekziston këndi i njoftimeve dhe informimit të studentëve ku afishohen informacione të ndryshme në lidhje me veprimtaritë që zhvillon fakulteti. Gjithashtu jashtë çdo departamenti ekziston këndi i informimit dhe njoftimeve që afishon departamenti përkatës.
<b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Konstatohet që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Uniko studentët kanë mundësi të informohen edhe në distancë <sup>159</sup> për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave online, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, studentët mund të gjejnë në faqen e ESSE-3 <sup>160</sup> , ku mund të informohen edhe për programet e studimit, provimet, vlerësimet e vazhduara dhe vlerësimet përfundimtare.
<b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për	Përmes Qendrës së Karrierës dhe Alumni, kandidatët për

<sup>159</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.3 Manual përdorimi i faqes UNIKO", ASCAL, Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>160</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 1.6, Manual i Sistemit Elektronik ESSE3", ASCAL, Dok. nr: 8 Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rumbullakëta, takimeve të studentëve që institucioni organizon. Gjithashtu ajo ofron informacion për bursa, konferenca studimore, informacion në lidhje me mobilitetet dhe programet e shkëmbimeve jashtë vendit. Praktikant profesional zhvillohen në institucione, shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti i edukimit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Konstatohet që QKA gjurmon studentët pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit<sup>161</sup>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<sup>161</sup> UNIKO, FEF, DE, "Shtojca 3.34, Databaza Alumni PP EFFH ", ASCAL, Dok. nr:76. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Edukimi për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Fan S. Noli” Korçë.**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i EFFH ka një shpërndarje të mirë të ngarkesës në katër semestra akademikë, duke mundësuar arritjen e objektivave formues të programit të studimit.
2. Institucion disponon infrastrukturën e nevojshme si klasa, laboratorë, studio e mjediset e tjera të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për të realizuar objektivat mësimorë të programit me karakter profesional të EFFH.
3. Në funksion të këtij programi studimi, insitucioni ka dy laboratorë funksionalë që mundëson zbatimin praktik të njohurive teorike. “Laboratori për zhvillimin profesional” është i dedikuar për veprimtaritë të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin në foshnjëri dhe në fëmijërinë e hershme.
4. Institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Departamentin e Shkencave të Edukimit të Universitetit të Bolonjës, Itali për hartimin dhe zhvillimin e kurrikulës, për krijimin e mjedisve infrastrukturore si për shkëmbim eksperiencash ndërmjet studentëve dhe stafit adakemik të programit të EFFH.
5. Institucioni ka realiuar marrëveshje bashkepunimi me OJQ Save the Children dhe me Bashkinë e Korçës për krijimin e kushteve për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike të cilat janë thelbësore për këtë program studimi.
6. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve për t’u informuar në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, plan programin, detyrimet dhe sistemin e vlerësimit të studentit nëpërmjet Katalogut të Studimeve për Programin e Studimit EFFH si dhe “Udhërrëfyesin e Studentit”.

**Pika të dobta**

1. Kurrikula shfaq mospërputhje të raporteve të veprimtarive formuese të nivelit V të KSHK bazuar në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
2. Nuk ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 15% e programit të studimit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.
3. Literatura e detyruar për studentët në modulet që ofron ky program studimi, nuk është e pesë viteve të fundit.

4. Institucioni nuk ka tregues të matshëm për një parashikim të numrit të studentëve të cilët mund të regjistrohen në vitin pasardhës akademik.
5. Konstatohet mungesa e një raportin analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.

### **Rekomandime**

1. Rekomandohet të rishikohet raporti i veprimtarive formuese të kurrikulës sipas nivelit V të KSHK bazuar në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".
2. Rekomandohet që të rishihet shpërndarja e moduleve karakterizuese që u japin studentëve aftësitë e nevojshme profesionale, në mënyrë që të arrihet një raport i balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit duhet t'i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.
3. Rekomandohet që të ketë një rishikim të literaturës bazë duke mundësuar përfshirjen e literaturës së pesë viteve të fundit, për të përmbushur detyrimin e akteve nënligjore në fuqi.
4. Rekomandohet realizimi e një studimi me tregues të matshëm për të parashikuar numrin e studentëve të cilët mund të regjistrohen në vitin e pasardhës akademik.
5. Rekomandohet realizimi nje raportin analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.

## **SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE PROFESSIONAL STUDY PROGRAM**

### **"Infant and Early Childhood Education" (IECE)**

**of the Higher Education Institution "Fan S. Noli", Korça**

### **BY SWOT METHOD**

#### **Strengths and affirmations**

1. The IECE program has a good distribution over four academic semesters, enabling the achievement of the formative objectives of the study program.
2. Institution has the necessary infrastructure such as classrooms, laboratories, ateliers, and other facilities equipped with electronic tools and information technology to achieve the learning objectives of the program of professional character of IECE
3. In the function of this study program, the institution has two functional laboratories that enable the practical application of theoretical knowledge. "Laboratory for the

professional development" is dedicated to activities that are directly related to development in infancy and early childhood.

4. The institution has realized a cooperation memorandum with the Department of Educational Sciences of the University of Bologna, Italy for the design and development of the curricula, for the creation of infrastructural environments for the exchange of experiences between students and the academic staff of the IECE program.
5. The institution has realized a cooperation memorandum with the NGO "Save the Children" and with the Municipality of Korça for the creation of conditions for the development of professional practices, internships, and other practical activities which are essential for this study program.
6. The institution has made available to students all the mechanisms to be informed in detail about the structure of the institution, organization, curricula, chores, and student assessment system through the "Catalog of Studies for the IECE Study Program" and "The Student Guide".

### **Weaknesses**


1. The curricula of this study program shows inconsistencies in the reports of training activities of level V of the ACC based on DCM no. 879, dated 18.12.2019 "On some changes and additions to the decision no. 41, dated 24.1.2018, of the Council of Ministers, "On the elements of study programs offered by higher education institutions".
2. There is no balanced ratio between theoretical versus practical modules/activities (50:50). About 15% of the study program is dedicated to training in practice / concrete work in the profession.
3. Compulsory literature for students in the modules offered by this study program is not of the last five years.
4. The institution does not have measurable indicators for a forecast of the number of students who can enroll in the following academic year.
5. It is ascertained the lack of a periodic analytical report on the quality of incoming and graduated students, as well as the degree of quality of their employment.

### **Recommendation**

1. It is recommended to be reviewed the ratio of curricula formative activities according to level V of the ACC based on DCM no. 879, dated 18.12.2019 "On some changes and additions to the decision no. 41, dated 24.1.2018, of the Council of Ministers, "On the elements of study programs offered by higher education institutions".
2. It is recommended to reconsider the distribution of characterizing modules that give students the necessary professional skills, to achieve a balanced ratio between the modules/activities of theoretical training versus practical ones (50:50). About 25% of

the program should be dedicated to training in practice / concrete work in the profession.

3. It is recommended to have a review of the basic literature enabling the inclusion of the literature of the last five years, to fulfill the obligation of the bylaws in force.
4. It is recommended to conduct a study with measurable indicators to predict the number of students who can enroll in the next academic year.
5. It is recommended to carry out a periodic analytical report on the quality of incoming and graduated students for this study program, as well as the quality of their employment.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
OFRIMI, Organizimi DHE drejtimi i programeve të studimit ME KARAKTER PROFESIONAL				X
STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X